



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:115266

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05692940

C.nr.1009/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses Kompania e Sigurimeve “Illyria” Sh.A., me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.B. nga Prishtina, kundër të paditurit J. (A) K. nga Prizreni, me objekt të kontestit rimbursimi i dëmit, vlera e kontestit 660.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të të paditurit, më datë 13.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “Illyria” Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit J. (A) K. nga Prizreni, për shkak të rimbursimit të dëmit.

II. DETYROHET i padituri, që paditëses, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 22.01.2020 në Deçan, t’ia paguajë shumën prej 660.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë (07.06.2021) deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET i padituri, që paditëses, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën e përgjithshme prej 20.00 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja Kompania e Sigurimeve “Illyria” Sh.A., me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.B. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurit J. (A) K. nga Prizreni, me objekt të kontestit rimbursimi i dëmit, vlera e kontestit 660.00 euro.

Në padi, është theksuar se më datë 22.01.2020, rreth orës 09:50, në Deçan, i padituri pa patent shofer ka shkaktuar aksident komunikacioni, duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës Shkoda, tipi Octavia, me targa 04-430-HE, duke mos mbajtur distancën e sigurisë ndërmjet automjeteve, godet veturën VW 1J, me targa dhe të dëmtuarit i shkakton dëm material në veturë, ndërsa S.Z. lëndime trupore. Automjeti i të paditurit në kohën e aksidentit ka qenë i siguar me policë të sigurimit nga autopërgjegjësia nr. 0007090705, me mbulesë siguroese nga data 03.07.2019 deri më 03.07.2020. Në bazë të kërkesës për zhdëmtimin e dëmit material në veturë nga Xh.B. dhe S.Z. për dëmin material dhe jomaterial të parashtruar nga ana e të dëmtuarve, të njëjtëve ia kompensoi dëmin në shumën e përgjithshme prej 660.00 euro. Andaj, pasi që i padituri pa njohuri

përkatëse për të drejtuar automjetin, në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke drejtuar automjetin pa patent shofer, ka shkaktuar aksident trafiku me automjet, sipas Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, paditësi ka fituar të drejtën të kërkoj rimbursimin e mjeteve të paguara në shumë prej 660.00 euro, me kamatë ligjore nga data e pagesës së dëmit deri në pagesën definitive. Andaj, ka propozuar që të aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadia dhe të detyrohet i padituri në kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

I padituri, në përgjigjen në padi ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Ka theksuar se rasti ka ndodhur aksidentalisht, ku në atë moment është lënduar rëndë. Familja e tij është rast social dhe është e papërbalueshme nëse të njëjtit do t'i ngarkohej ndonjë dënim. Andaj, ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe fjalës përfundimtare, i autorizuari i paditëses ka deklaruar se në bazë të provave të administruara, u vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë si dhe lartësia e saj. U vërtetua se i padituri ka shkaktuar aksident trafiku pa patent shofer dhe konform dispozitave ligjore të LSDA-së, i njëjti e ka humbur mbulesën siguroese të polisës së sigurimit dhe pas kompensimit të të dëmtuarve, paditëses i ka lindur e drejta e regresit ndaj shkaktarit të aksidentit. Ndërsa lartësia e kërkesëpadisë u vërtetua me anë të vlerësimeve mjekësore dhe vlerësimit të dëmit material nga ana e ekspertëve. Në bazë të kësaj, i propozojmë gjykatës që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe ta detyroj të paditurin që në emër të rimbursimit të dëmit të aksidentit të datës 22.01.2020, paditëses t'ia paguaj shumën prej 660 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 07.06.2021, si datë e dorëzimit të padisë në gjykatë sipas mendimit juridik nga Gjykata Supreme, si dhe i kërkojmë edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 21 euro në emër të taksës gjyqësore.

Shqyrtimin kryesor, gjykata e ka mbajtur në mungesë të të paditurit, në përputhje me nenin 423 par. 4 i Ligjit për procedurën kontestimore (LPK). Më saktësisht, gjykata me aktvendimin C.nr.1009/2021 e datës 18.03.2024, ka vendosur që të gjitha dorëzimet dhe komunikimi me të paditurin J.K. të bëhet përmes afishimit në tabelën e shpalljes së kësaj gjykate. Kështu, në përputhje me nenin 116 të LPK-së, një komunikim i tillë është i ligjshëm dhe i rregullt me palën e paditur, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: raportin policor të aksidentit me numër DR-3004-55-20 e datës 22.02.2020, kërkesën për kompensim dëmi material dhe jomaterial nga Xh.B. raportin mjekësor për S.Z. me numër të protokollit 1231 i datës 22.01.2020 lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë, vlerësimin mjekësor për S.Z. marrëveshjen jashtëgjyqësore për S.Z. e datës 02.03.2020, dëshminë e pagesës për dy të dëmtuarit e datës 09.03.2020, librezën e qarkullimit të automjetit në emër të të dëmtuarit Xh.B. procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit për Xh.B. 7 fotot e automjetit të dëmtuar, pajtimin jashtëgjyqësor për Xh.B. më datë 02.03.2020 dhe vlerësimin e dëmit për të dëmtuarin Xh.B. i datës 21.02.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe ka vërtetuar se:

- kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga leximi i raportit policor të aksidentit me numër DR-3004-55-20 i datës 22.02.2020, vërtetohet se më datë 22.01.2020, rreth orës 09:50, në rrugën Gjakovë-Deçan, në sheshin “Mentor Tolaj” në Deçan, pikërisht afër rreth rrotullimit, i padituri ka shkaktuar aksident komunikacioni, ku duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës Shkoda, tipi Octavia, me targa duke mos mbajtur distancën e sigurisë ndërmjet automjeteve, ka goditur veturën VW 1J, me targa dhe shkakton dëm dhe lëndime.

Nga leximi i kërkesës për kompensim dëmi material dhe jomaterial nga Xh.B. dhe S.Z. u vërtetua se të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit të datës 22.01.2020, Xh.B. dhe S.Z. kanë parashtruar kërkesë pranë paditëses për kompensim të dëmit të shkaktuar.

Nga leximi i raportit mjekësor për S.Z. me numër të protokollit 1231 i datës 22.01.2020 lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë, është vërtetuar se në datën e lartcekur, në ora 10:40, i dëmtuari S.Z. ka bërë një vizitë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë, dhe ndaj të njëjtit është udhëzuar bërja e analizave laboratorike përkatëse dhe terapia që duhet përdorur pas trajtimit në Spital.

Nga leximi i vlerësimit mjekësor për S.Z. i datës 14.02.2020, vërtetohet se cenzori i paditëses-ortopedi, ka vlerësuar se i dëmtuari S.Z. ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të lartë për 1 ditë dhe dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për 5 ditë dhe frikë të intensitetit të ulët për 1 ditë dhe shërim i këtij dëmi ka zgjatuar 15 ditë.

Nga leximi i marrëveshjes jashtëgjyqësore për S.Z. e datës 02.03.2020, është vërtetuar se më datë 02.03.2020, paditësja dhe i dëmtuari S.Z. kanë arritur pajtim jashtëgjyqësor, ku paditësja në emër të të gjitha formave të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 22.01.2020, i ka paguar të dëmtuarit shumën prej 565.00 euro.

Nga leximi i dëshmisë së pagesës për dy të dëmtuarit e datës 09.03.2020, vërtetohet se paditësja ka bërë pagesën në shumën prej 660.00 euro, në llogarinë e të autorizuarës së të dëmtuarit S.Z. av. M.B. 565.00 euro dhe 95.00 euro për dy të dëmtuarit.

Nga leximi i librezës së qarkullimit të automjetit në emër të të dëmtuarit Xh.B. u vërtetua se i dëmtuari Xh.B. është pronar i veturës së tipit Golf 1.9 TDI 1J, me targa dhe data e regjistrimit të veturës është 04.10.2019.

Nga leximi i procesverbalit mbi dëmtimin e automjetit për Xh.B. është vërtetuar se vetura e tipit Golf 1.9 TDI 1J, me targa ngjyrë hiri, ka pasur të dëmtuar mbrojtësin- shinën e mbrojtësit në pjesën e pasme të saj.

Nga shikimi i 7 fotove të automjetit të dëmtuar, vërtetohet se vetura e tipit Golf 1.9 TDI 1J, me targa ngjyrë hiri, është dëmtuar në pjesën e pasme, në anën e majtë të saj.

Nga leximi i pajtimit jashtëgjyqësor për Xh.B. më datë 02.03.2020, është vërtetuar se më datë 02.03.2020, paditësja dhe i dëmtuari Xh.B. kanë arritur pajtim jashtëgjyqësor, ku paditësja në emër të të gjitha formave të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 22.01.2020, i ka paguar të dëmtuarit shumën prej 95.00 euro.

Nga leximi i vlerësimit të dëmit për të dëmtuarin Xh.B. i datës 21.02.2020, vërtetohet se dëmi i shkaktuar në veturën e tipit Golf 1.9 TDI 1J, me targa ngjyrë hiri, rezulton të jetë në shumën e përgjithshme prej 95.00 euro.

Baza Ligjore

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Më konkretisht, me nenin 14 par. 1 pika 1.2. parashihet që “i siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit”. Pastaj, me par. 2 të këtij neni është paraparë se “humbja e të drejtave nga sigurimi, siç përcaktohen me dispozitat e paragrafit 1 nënparagrafi 1.2. të këtij neni, nuk është me ndikim në të drejtën e palës së tretë në dëmshpërblim”. Ndërsa me par. 3 të nenit 14 të ligjit të lartcekur është paraparë se “siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”.

Gjithashtu me nenin 960 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet që “me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”.

Ndërsa, me nenin 7 par. 1 të LPK-së është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Me nenin 2 par. 2 të LPK-së është paraparë se “gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka vërtetuar se nuk ishte kontestuese se i padituri J. (A) K. nga Prizreni, më datë 22.01.2020, rreth orës 09:50, në Deçan, në rrugën Gjakovë-Deçan, në sheshin “Mentor Tolaj”, pikërisht afër rreth rrotullimit, ka ndodhur një aksident i komunikacionit, ashtu që i padituri duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës Shkoda, tipi Octavia, me targa 04-430-HE, duke mos mbajtur distancën e sigurisë ndërmjet automjeteve, godet veturën VW 1J, me targa dhe të dëmtuarit Xh.B. i shkakton dëm material në veturë, ndërsa të dëmtuarit S.Z. lëndime trupore.

Kështu, i padituri J.K. ka qenë fajtor apo përgjegjës kryesor në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit të datës 22.01.2020, pasi që i njëjti ka qenë duke drejtuar automjetin e markës Shkoda, tipi Octavia, pa pasur patentë shofer, respektivisht nuk ka pasur leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik. Gjithashtu, i padituri si drejtues i automjetit, me rastin e shkaktimit të aksidentit të komunikacionit të cekur më lartë, nuk ka respektuar edhe rregullat tjera të përcaktuara me ligjin për komunikacion rrugor, duke mos mbajtur distancën e nevojshme të sigurisë dhe si pasojë e të gjithë këtyre fakteve, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit. Të gjitha këto fakte, gjykata i ka vërtetuar përmes provave materiale të administruara, konkretisht nga raporti i aksidentit numër DR-3004-55-20 i datës 22.02.2020. Andaj, mbi provën dhe faktet e theksuara më lartë, gjykata ka vlerësuar se është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së palës paditëse.

Në anën tjetër, gjykata lartësinë e dëmit e ka vërtetuar nga provat materiale lidhur me vlerësimin dhe raportin mjekësor për të dëmtuarit. Më konkretisht, nga raportit mjekësor për S.Z. me numër të protokollit 1231 i datës 22.01.2020 lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë, vlerësimi mjekësor

për S.Z. i datës 14.02.2020, rezulton dhe vërtetohet në mënyrë konkrete lëndimet që ka pësuar i dëmtuari S.Z. në aksidentin e komunikacionit të datës 22.01.2020 dhe lartësia apo kohëzgjatja e dëmtimeve që i dëmtuari i lartcekur ka përjetuar. Pastaj, nga procesverbali mbi dëmtimin e automjetit për Xh.B. 7 fotot e automjetit të dëmtuar dhe vlerësimi i dëmit për të dëmtuarin Xh.B. i datës 21.02.2020, rezulton dëmi material dhe lartësia e tij, që i dëmtuari Xh.B. ka pësuar në veturën Golf 1.9 TDI 1J, me targa nga aksidenti i komunikacionit të datës 22.01.2020. Ndërsa, nga dëshmia e pagesës për dy të dëmtuarit e datës 09.03.2020, marrëveshja jashtëgjyqësore për S.Z. e datës 02.03.2020 dhe pajtimi jashtëgjyqësor për Xh.B. më datë 02.03.2020, në mënyrë të qartë dhe konkrete provohet se paditësja ka bërë kompensimin e dëmit në shumë prej 565.00 euro ndaj të dëmtuarit S.Z. dhe në shumë prej 95.00 euro ndaj të dëmtuarit Xh.B. si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 22.01.2020.

Andaj, në përputhje me nenin 14 par. 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, gjykata ka vlerësuar se i padituri ka detyrim, përkatësisht paditësja ka të drejtë të kërkojë nga i padituri rimbursimin e dëmit të paguar ndaj personave të tretë- të dëmtuarve: S.Z. dhe Xh.B. në aksidentin e komunikacionit të datës 22.01.2020, në Deçan.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 07.06.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata vlerësoi pretendimet e palës së paditura paraqitur në përgjigje në padi, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk kanë mbështetje në asnjë bazë faktike dhe juridike.

Gjykata ka bërë vlerësimin edhe të provave të tjera të administruara dhe të përmendura më lartë, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, bazuar në nenin 452 par. 1 lidhur me nenin 463 par. 2 të LPK-së, duke e detyruar të paditurin t'i kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore paditëse, në shumën prej 20.00 euro, në emër të taksës gjyqësore.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore të cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1009/2021, datë 13.05.2024

Gjyqtari
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta e ankesës në afatin prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.